



Pas vaksinës tuaj Comirnaty (Pfizer/ BioNTech) COVID-19

Ju faleminderit që po e mbroni veten dhe të tjerët duke bërë vaksinën. Tani që e keni bërë vaksinën tuaj, ne ju kërkjmë që ta lexoni këtë dokument me kujdes, në mënyrë që të dini se çfarë duhet të prisni që të ndjeni në pak ditët e ardhshme dhe ku të merrni më shumë informacion. Lexojeni edhe fletëpalosjen e vaksinës së COVID-19 që ju kemi dhënë.

Ne po ju japim edhe një fletë në të cilën thuhet se e keni bërë vaksinën sot. **Ju lutemi mbajeni kartën e bërjes së vaksinës të sigurt.**

Çfarë mund të ndodhë në pak ditët e ardhme?

Disa njerëz që e kanë bërë vaksinën që bëtë ju sot do të:

- jenë pak të ndjeshëm, do të kenë ënjtje dhe/ose skuqje në krahun ku kanë bërë injeksionin e vaksinës
- ndihen të lodhur
- kenë dhimbje koke
- kenë dhimbje muskujsh
- kenë dhimbje kyçesh
- kenë të përziera
- kenë temperaturë (temperaturë prej 38 gradë celsius ose më e lartë).

Sikurse me të gjitha vaksinat, ju mund t'i raportoni efektet anësore të dyshuara te Autoriteti Rregullor i Produkteve (HPRA).

Për të raportuar efektet anësore të vaksinës së COVID-19, ju lutemi vizitoni **www.hpra.ie/report**.

Çfarë ndodh nëse unë kam temperaturë ose kam dhimbje?

Nëse keni temperaturë apo keni dhimbje, mund të merrni paracetamol ose ibuprofen për t'ju ndihmuar. Megjithatë, nëse temperatura juaj zgjat më shumë se 48 orë ose nëse jeni ende të shqetësuar, ju lutemi kërkoni këshilla mjekësore. Mos merrni ibuprofen nëse jeni shtatzënë.

A më duhet të bëj ndonjë gjë përpara se të marr dozën e dytë të vaksinës?

Kur të merrni dozën tjetër dhe përfundimtare të vaksinës, ju lutemi thuajini ekipit të vaksinave nëse ka pasur ndonjë ndryshim në historikun tuaj mjekësor.

Silleni kartën tuaj të regjistrimit të vaksinave me vete kur shkoni për të bërë dozën e dytë.

Kjo gjë do të bëhet pas 28 ditësh (katër javë).

Lajmet e mira

Bërja e vaksinës COVID-19 duhet t'ju mbrojtë nga ndërlikimet e rënda të COVID-19.

Vaksinat i mësojnë sistemit tonë imunitar t'ju mbrojnë nga sëmundjet. Është shumë më e sigurt për sistemin tonë imunitar që ta mësojë këtë nëpërmjet vaksinimit se sa të infektohet me COVID-19.

Ne ende po mësojmë

Duhen 7 ditë pasi të bëhet doza e parë e vaksinës që ajo të funksionojë.

Ka një mundësi të vogël që sërish të merrni COVID-19 edhe nëse e keni bërë vaksinën.

Ne nuk e dimë ende nëse bërja e vaksinës ju pengon që ta përhapni virusin tek të tjerët, ndaj duhet të vazhdoni të ndiqni këshillat e shëndetit të publik:

- Ndiqni udhëzimet e distancimit social (qëndroni dy metra larg nga të tjerët kur është e mundur)
- mbani një maskë
- lani duart rregullisht.

Keni ndonjë pyetje?

Nëse nuk jeni të sigurt rreth diçkaje ose keni ndonjë pyetje rreth vaksinës COVID-19, ju lutemi na pyesni tani ose vizitoni [hse.ie/covid19vaccine](https://www.hse.ie/covid19vaccine) ose telefononi HSELive në numrin **1850 24 1850**.

Botuar nga HSE më 14 janar 2021.
Versioni 3.



Rialtas na hÉireann
Government of Ireland